



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 15.10.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1057_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 16 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë,
- Dispozitat e Nenit 7 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit,
- Kërkesën e KQKO për amandamentimin e Kodit të Rrjetit – Kodi Operativ të datës 03 gusht 2018,

në seancën e mbajtur me datë 15.10.2018, nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** amandamentimi i dokumentit “Kodi i Rrjetit - Kodi Operativ” të KOSTT Sh.a., si në shtojcë të këtij vendimi.

Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 04.10.2017 ka pranuar kërkesën e KQKO për amandamentimin e dokumentit “Kodi i Rrjetit - Kodi Operativ” të harmonizuar Doracakun e Operimeve ENTSO-E (*European Network of Transmission System Operators for Electricity*)(Politika 5). Në këtë kuadër janë shtuar disa pika si edhe është bërë përshtatja e termave sipas legjislacionit në fuqi, përmirësime gjuhësore dhe rregullime të tekstit.
- o ZRRE ka dhënë komente gjatë periudhës amandamentuese si pjesëmarrëse aktive në KQKO, por edhe pas dërgimit të dokumentit për aprovim në ZRRE, të cilat janë përfshirë në dokument.
- o Pas përfshirjes së të gjitha komenteve dhe finalizimit të dokumentit, KQKO me datë 03.08.2018 ka dërguar dokumentin “Kodi i Rrjetit - Kodi Operativ” në ZRRE me kërkesën për aprovimin e amandamentimit të tij.